



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 nëntor 2024
Nr. Ref.: RK 2581/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI156/23

Parashtruese

Elvan Imami

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. AC-I-21-0781-A0001, të 6 prillit
2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Elvan Imami (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [AC-I-21-0781-A0001] të 6 prillit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS), përmes së cilit është vërtetuar Aktgjykimi [C-III-12-0055] i 11 nëntorit 2021, i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [E drejta në pronë dhe mbrojtje të pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 korrik 2023, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 gusht 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. Gjr. KI156/23], caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu - Krasniqi gjyqtare raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 28 gusht 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës së bashku me M.I dhe Z.I, më 17 dhjetor 2008 kishte ngritur padinë [C.nr. 849/08] pranë Gjykatës Komunale në Prizren kundër KBI "Progres-Export", duke kërkuar anulimin e kontratës nr. 11647/554 mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të 20 nëntor 1963, si dhe dorëzimin në

posedim të ngastrës nr.5118, në vendin e quajtur “Kamenica”, me sipërfaqe 24.99 ari dhe ngastrës kadastrale nr. 5157, në vendin e quajtur “ Jaglenica”, me sipërfaqe prej 40.00 ari.

11. Më 7 maj 2010, parashtruesja së bashku me dy paditësit e tjerë i kishin propozuar Gjykatës Komunale në Prizren caktimin e masës së përkohshme mbi pronën kontestuese, respektivisht duke kërkuar që e njëjta të mos tjetërsohet.
12. Më 1 nëntor 2011, përmes Aktvendimit [C.nr. 607/11], Gjykata Komunale në Prizren ishte shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe dërgoi shkresat e lëndës pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si gjykatë kompetente.
13. Më 21 dhjetor 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme:AKP) parashtrroi mbrojtjen pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, përmes së cilës deklaroi se padia duhet të refuzohet si e pabazuar. AKP në mbrojtjen e saj thekson se (i) kërkesëpapia është pa bazë juridike dhe faktet në të cilat është mbështetur janë në kundërshtim me provat të cilat i ka prezantuar parashtruesja; (ii) pretendimet e paditësve për anulim të kontratës nuk kanë mbështetje ligjore; (iii) padia nuk përmban elementet thelbësore që duhet t'i përmbajë një padi; dhe se (iv) kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për anulimin e kontratës.
14. Më 18 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës precizoi kërkesëpadinë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme duke informuar këtë të fundit se paditësit M.I dhe Z.I kishin vdekur, dhe se parashtruesja ishte e vetmja trashëgimtare. Ndër të tjera, parashtruesja thekson se duhet të bëhet korrigjimi i numrave të ngastrave dhe në vend të nr. 5118 është korrigjuar me numrin 5128.
15. Më 24 prill 2014, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme mbajti seancë dëgjimore, në të cilën u bë korrigjimi i numrave të ngastrave dhe në vend të nr. 5118 është korrigjuar me numrin 5128.
16. Më 3 janar 2019, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kërkesë/propozim për lëshimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, e cila sipas saj do të pamundësonte tjetërsimin e pronës kontestuese deri në një vendim meritor.
17. Më 7 shkurt 2019, përmes Aktvendimit [C-III-12-0055], Kolegji i Specializuar i DHPGJSK-së refuzoi kërkesën e parashtrueses për lëshimin e masës të sigurisë, me arsyetimin se parashtruesja nuk ka ofruar dëshmi të besueshme që do të arsyetonte lëshimin e një urdhri paraprak gjyqësor.
18. Më 26 shkurt 2019, parashtruesja ka paraqitur ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJSK-së kundër vendimit të lartpërmendur, me pretendimin se i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike.
19. Më 21 mars 2019, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-19-0027], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi vendimin e shkallës parë, duke theksuar, ndër të tjera, se parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme jo vetëm për të drejtën pronësore por as prova që do e dëshmonin dëmin e menjëhershëm dhe të riparueshëm që do të ndodhte në rast të mos lëshimit të masës së përkohshme, si kusht për lëshimin e masës së përkohshme.

20. Në seancën dëgjimore të 21 tetorit 2021, lidhur me meritat e rastit parashtruesja e kërkesës kërkoi që të njëjtës t'i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese nr. 5157 dhe qëndroi pas padisë për anulimin e kontratës së kontestuar. Parashtruesja propozoi që nëse nuk është mundësia të kthehet pronësia e ngastrës kontestuese, atëherë të caktohet kompensimi me të holla sipas vlerës së tregut. Në anën tjetër edhe AKP qëndroi pas asaj që është thënë në mbrojtjen e dhënë duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e parashtrueses.
21. Më 11 nëntor 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [C-III-12-0055], refuzoi padinë e parashtrueses si të pabazuar. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, në arsyetim të Aktgjykimit të tij thekson se Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i RSFJ-së i vitit 1978, në të cilin thirret parashtruesja nuk ofron mundësinë e revokimit të kontratës së shitjes, pasi dispozitat e tij në lidhje me nulitetin e kontratave nuk mund të zbatohen për veprimet juridike të vitit 1963 kur edhe është nënshkruar kontrata e kontestuar. Më tej, në Aktgjykim shtohet se ka kaluar afati për kërkimin e anulimit të kontratës i cili ka qenë një vit nga data e lidhjes së saj, në rastin konkret kanë kaluar mbi 44 vite dhe për më tepër parashtruesja nuk ka parashtruar prova mbi faktet e pretenduara.
22. Më 1 dhjetor 2021, parashtruesja e kërkesës, parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartpërmendur në Kolegji të Apelit të DHPGJSK-së, me të njëjtat pretendime sa i përket kërkesës lidhur me të drejtën për anulimin e kontratës së kontestuar dhe njohjen e të drejtave pronësore ndaj ngastrave kontestuese, me arsytet e njëjta të dhëna në padinë kryesore. E njëjta propozon të aprovohet ankesa, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet kërkesëpapia ose të anulohet ky Aktgjykim dhe lënda të dërgohet për rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë.
23. Më 23 nëntor 2022, AKP në përgjigjen e saj theksoi se parashtruesja nuk ka arritur të ofroj asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të saj apo të rrëzoj argumentet ligjore të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë.
24. Më 6 prill 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJK-së, përmes Aktgjykimit [AC-I-21-0781-A0001], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe e vërtetoi Aktgjykimin e shkallës së parë.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

25. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara lidhur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [E Drejta në pronë dhe mbrojtje të pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
26. Parashtruesja e kërkesës fillimisht para Gjykatës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur asaj të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë respektivisht nenin 31 dhe 46, duke mos shqyrtuar propozimin e parashtrueses drejtuar Gjykatës Komunale, të 7 majit 2010, për caktimin e masës së përkohshme të ndalimit dhe tjetërsimit të patundshmërisë e cila është objekt i këtij kontesti, dhe se Gjykata Komunale nuk ka marrë asnjë vendim në lidhje me këtë propozim.
27. Sipas parashtrueses *“po që se gjykata me kohë do të merrte në shqyrtim këtë propozim të paditëse për marrjen e masës së përkohshme, patundshëria e cila është objekt i këtij kontesti nuk do të ishte tjetërsuar nga ana e AKP”*. Më tej parashtruesja thekson se AKP-ja parcelën kontestuese e kishte shitur te një person fizik me procedurë të marrëveshjes së menjëhershme dhe në këtë mënyrë sipas saj *“paraqet*

sulm në pronën e paditëses e cila i është marrë, absolutisht me kontratë të pavlefshme”.

28. Parashtruesja thekson se në rastin konkret padia është parashtruar në vitin 2008 dhe sipas saj gjatë periudhës 15 vjeçare janë mbajtur vetëm tri shqyrtime gjyqësore.
29. Në kërkesën e saj, parashtruesja gjithashtu thekson se gjykatat e rregullta në rastin konkret është dashur ta kenë parasysh edhe *“Ligjin mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme (Gazeta zyrtare e KSAK nr.45/81 ...)”* dhe sipas saj në këtë mënyrë kontrata do të shpallej e pavlefshme duke shtuar se *“Gjykata nuk ka vlerësuar drejtë faktin se gjatë kohës së misionit të UNMIK-ut në Kosovë, ka qenë në fuqi dispozita ligjore mbi nulitetin e kontratës”.*
30. Në fund parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

KONVENTA EVROPIANE PER TE DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-21-0781-A0001] të 6 prillit 2023, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
35. Megjithatë, përveç këtyre kritereve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullit (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së, Kemmachev kundër Francës, Kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), Mentzen kundër Letonia, Kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).
37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlihet me padinë e ushtruar nga parashtruesja e kërkesës fillimisht në Gjykatën Komunale në Prizren kundër të KBI “Progres-Export”, duke kërkuar anulimin e kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë nr. 11647/554, të datës 20 nëntor 1963. Më pas, pas parashtrimit të padisë, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Komunale edhe vendosjen e masës së përkohshme mbi ngastrën kontestuese. Më 1 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prizren ishte shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe i dërgoi shkresat e lëndës pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme si gjykatë kompetente. Më pas në vitin 2019, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kërkesë/propozim për lëshimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, e cila sipas saj do të pamundësonte tjetërsimin e pronës kontestuese deri në një vendim meritior. Kolegji i Specializuar kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses për lëshimin e masës të sigurisë. Vendimi i shkallës së parë lidhur me masën e sigurisë ishte vërtetuar edhe nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me meritat e rastit refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses duke theksuar se Ligji

mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i RSFJ-së i vitit 1978, në të cilin thirret parashtruesja nuk ofron mundësinë e revokimit të kontratës së shitjes, pasi dispozitat e tij në lidhje me nulitetin e kontratave nuk mund të zbatohen për veprimet juridike të vitit 1963 kur edhe është nënshkruar kontrata e kontestuar. Më tej në Aktgjykim shtohet se ka kaluar afati për kërkimin e anulimit të kontratës, i cili ka qenë një vit nga data e lidhjes së saj, në rastin konkret kanë kaluar mbi 44 vite dhe se parashtruesja nuk ka parashtruar prova mbi faktet e pretenduara. Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, i cili kishte vendosur për meritat e rastit ishte miratuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së.

39. Së pari, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në mënyrë shprehimore para Gjykatës konteston Aktgjykimin [AC-I-21-0781-A0001] e 6 prillit 2023, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes së cilit ishte vendosur në merita duke u refuzuar padia e saj.
40. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
41. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses të kërkesës ka të bëjë me shkeljen e nenit 31, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe që ka të bëjë me (i) mos vendosjen nga ana e Gjykatës Komunale në Prizren lidhur me kërkesën e parashtrueses për masë të sigurisë ; (ii) zbatimin e gabuar dhe arbitrar të ligjit; (iii) tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, si dhe (iv) pretendimi për shkeljen e nenin 46 të Kushtetutës.
42. Gjykata në vijim këto pretendime do t'i trajtojë ndaras, për aq sa ato mund të trajtohen ndaras.

Përkitazi me pretendimet nën pikën (i)–mos vendosjen nga ana e Gjykatës Komunale lidhur me kërkesën e parashtrueses për masë të sigurisë

43. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në thelb thekson se pas parashtrimit të padisë në Gjykatën Komunale në Prizren, respektivisht më 7 maj 2010 kishte parashtruar në Gjykatë Komunale në Prizren edhe kërkesë për masë të sigurisë mbi pronën kontestuese. Sipas saj, Gjykata Komunale në Prizren asnjëherë nuk kishte vendosur lidhur me kërkesën e saj për masën e sigurisë.
44. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Prizren, përmes Aktvendimit [C.nr. 607/11], ishte shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe i dërgoi shkresat e lëndës pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si gjykatë kompetente.
45. Më pas më 3 janar 2019, parashtruesja kishte parashtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kërkesë/propozim për lëshimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, e cila kërkesë ishte refuzuar nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [C-III-12-0055] të 7 shkurtit 2019, me arsyetimin se parashtruesja nuk ka ofruar dëshmi të besueshme që do të arsyetonte lëshimin e një urdhri paraprak gjyqësor. Vendimi i lartpërmendur me të cilin Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses për vendosjen e masës së përkohshme, pas ankesës së parashtrueses ishte mbështetur në plotni nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së.
46. Gjykata nga si më sipër vëren se Gjykata Komunale në Prizren, e cila ishte shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore, dhe shkresat e lëndës i kishte përcjellë në

DHPGJS, nuk ka pasur kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me këtë çështje në merita apo lidhur me kërkesën e parashtrueses për masë të sigurisë.

47. Megjithatë nga shkresat e lëndës, vërehet se kërkesa e saj ishte trajtuar nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, si në merita të rastit edhe në kërkesën e saj për masë të sigurisë.
48. Andaj si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ky pretendim i parashtrueses ishte adresuar nga gjykatat e rregullta dhe Gjykata nuk do të lëshohet më tej në elaborim të këtij pretendimi.

Përkitazi me pretendimet nën pikën (ii) – zbatimin e gabuar dhe arbitrar të ligjit

49. Parashtruesja e kërkesës, në pretendimet e saj të paraqitura para Gjykatës, gjithashtu ngrit edhe çështje të interpretimit dhe zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Kolegjit të Specializuar si dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
50. Parashtruesja e kërkesës thekson se gjykatat e rregullta në rastin konkret është dashur ta kenë parasysh edhe "*Ligjin mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme (Gazeta zyrtare e KSAK nr.45/81 ...)*" dhe sipas saj në këtë mënyrë kontrata do të shpallej e pavlefshme, duke shtuar se "*Gjykata nuk ka vlerësuar drejtë faktin se gjatë kohës së misionit të UNMIK-ut në Kosovë, ka qenë në fuqi dispozita ligjore mbi nulitetin e kontratës*".
51. Prandaj, bazuar në shtjellimet e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
52. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KI87/20, parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 57; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtrues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55 dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
53. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Ballktaş Bingöllü kundër Turqisë*, GJEDNJ, nr. 76730/12, i 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

54. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Ruisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Pëduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
55. Në rastin konkret, Gjykata ka parasysh fillimisht se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së kishte refuzuar padinë e parashtrueses me arsyetimin se një kërkesë e tillë ishte parashtruar jashtë gjitha afateve që parasheh legjislacioni në fuqi, marrë parasysh faktin se parashtruesja në rastin konkret kishte mundur të kërkonte anulimin e kontratës 1 vit pas lidhjes së saj dhe në rastin konkret një kërkesë e tillë është parashtruar pas 44 vitesh.
56. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [C-III-12-0055], të 7 shkurtit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, ku ndër të tjera kishte theksuar se Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978, në të cilin thirret parashtruesja e kërkesës *“nuk ofron mundësinë e revokimit të kontratës së shitjes, pasi që ai rregullon nulitetin e kontratave”* por këto dispozita nuk mund të zbatohen për veprimet juridike të ndodhura gjatë vitit 1963, kur ishte nënshkruar kontrata e shitblerjes, duke theksuar se që nga ajo periudhë pronat kishin kaluar në emër të KBI “Progres-Export” dhe se parashtruesja që nga ajo periudhë nuk e kishte kontestuar asnjëherë këtë kontratë. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së më tej shton se edhe bazuar në nenin 26 të Ligjit mbi Qarkullimin e Tokës dhe Ndërtesave, *“Kontratat për të cilat pretendohen të jenë lidhur në mungesë të vullnetit të palëve paditësit kanë mundur të kërkojnë anulimin e kësaj kontrate një vit nga dita e lidhjes së kësaj kontrate”*. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, gjithashtu kishte theksuar se *“edhe nëse supozohet se neni 8a i Ligjit Serb me Ndryshime i datës 23 korrik 1987 ishte i zbatueshëm në Kosovë nuk do të mund të kërkohej anulimi i kontratës i vitit 1963, sepse kjo padi është dorëzuar më shumë se 44 vjet pas lidhjes së kontratës dhe më shumë se 20 vjet pas mitratimit të Ligjit Serb të lartpërmendur”*.
57. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, në arsyetim të aktgjykimit të tij kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë duke theksuar se *“Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me konstatimet e Kolegjit të Shkallës së parë edhe sa i përket humbjes së mundësisë për të kërkuar një të drejtë të cilën askush nuk e ka kërkuar për më shumë se 44 vjet, e që sipas nenit 26 paragrafi 4 të Ligjit mbi Qarkullimin e Palujtshmërive nr.26/1954 këtë të drejtë ka mundur ta shfrytëzoj deri një vit nga dita e nënshkrimit të kontratës.”*
58. Nga si më sipër Gjykata nga arsyetimet e gjykatave të rregullta dhe nga vet përmbajtja e dispozitave ligjore vëren se parashtruesja kërkesën e saj për anulimin e kontratës së shitblerjes e ka kërkuar jashtë të gjitha afateve të përcaktuara ligjore.
59. Gjykata ripërsërit se Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime

janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës të cituar më lart, KI75/17, parashtrues X, paragrafi 59).

60. Megjithatë, bazuar në shtjellimet e mësipërme, si dhe interpretimin dhe arsyetimin e dhënë, në rastin konkret, nuk është dëshmuar që ka arbitraritet në interpretimin e dhënë nga Kolegji i Specializuar apo Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me rastin e refuzimit të padisë së parashtrueses.
61. Prandaj, Gjykata thekson se parashtruesja kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i aplikimit në mënyrë diskriminuese të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i "ligjshmërisë" i gjykatave të rregullta, mund të ketë qenë jo i drejtë.
62. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesja në kërkesën e saj nuk ka arritur të dëshmojë dhe të mbështesë pretendimin e saj se si Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale kanë shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimet nën pikën (iii) për tejzgjatje të procedurave gjyqësore

63. Në trajtim të këtij pretendimi, Gjykata fillimisht rikujton edhe një herë këtë pretendim të parashtrueses, e cila ndër të tjera thekson në rastin konkret po që se "*gjykata me kohë do të merrte në shqyrtim këtë propozim të paditëse për marrjen e masës së përkohshme, patundshëria e cila është objekt i këtij kontesti nuk do të ishte tjetërsuar nga ana e AKP-*". Më tej parashtruesja thekson se AKP-ja parcelën kontestuese e kishte shitur te një person fizik me procedurë të marrëveshjes së menjëhershme dhe në këtë mënyrë sipas saj "*paraqet sulm në pronën e paditëses e cila i është marrë, absolutisht me kontratë të pavlefshme*".
64. Parashtruesja thekson se në rastin konkret padia është parashtruar në vitin 2008, dhe sipas saj gjatë periudhës 15 vjeçare janë mbajtur vetëm tri shqyrtime gjyqësore.
65. Përkitazi me pretendimin për tejzgjatje të procedurës, Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se neni 6 (1) i KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91).
66. Sa i përket shtrirjes në kohë të procedurave, Gjykata merr parasysh kriteret e GJEDNJ-së të përcaktuara në Aktgjykimin e rastit *Tomazič kundër Sllovenisë*, (Aktgjykimi i 2 qershorit 2008, paragrafi 54), ku përcaktohet si në vijim: "*Sa i përket arsyeshmërisë së zgjatjes së procedurave, [GJEDNJ] thekson se kjo duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë ishte në pyetje për parashtruesin në këtë mosmarrëveshje*".
67. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës së saj, ka vlerësuar se përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer*

kundër Austrisë, të 23 prillit 1987, paragrafi 64, shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë*, GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 50, dhe rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI127/15, me parashtrues *Mile Vasoviç*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 qershorit 2015, paragrafi 43, KI81/16, me parashtrues *Valdet Nikqi*, Aktgjykim i 31 majit 2017, KI19/17, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 shkurtit 2018, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74).

68. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kemi të bëjmë me një kontest pronësor i cili fillimisht është iniciuar me padi nga parashtruesja e kërkesës më 17 dhjetor 2008 dhe në vitin 2010 kishte parashtruar edhe kërkesë për masë të përkohshme. Gjykata Komunale ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe nga shkresat e lëndës vërehet se në vitin 2012 kishte transferuar rastin në gjykatën kompetente, respektivisht në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Më pas në vitin 2012, AKP parashtroj mbrojtje në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ndaj padisë së parashtrueses. Më 18 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës precizoi kërkesëpadinë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Më 24 prill 2014, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme mbajti seancë dëgjimore, lidhur me rastin. Në vitin 2019, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kërkesë/propozim për lëshimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë. Më 7 shkurt 2019, Kolegji i Specializuar i DHPGJSK-së refuzoi kërkesën e parashtrueses për lëshimin e masës të sigurisë dhe pas ankesës së parashtrueses, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 21 mars 2019 vërtetoi vendimin e shkallës së parë lidhur me kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme. Më pas, më 21 tetor 2021, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së mbajti seancë shqyrtuese lidhur me meritat e rastit dhe më 11 nëntor 2021, ky i fundit refuzoi padinë si të pabazuar. Pas ankesës së parashtrueses, më 6 prill 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJK-së, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi Aktgjykimin e shkallës së parë. Prandaj në rastin konkret Gjykata do të vlerësoj periudhën që nga viti 2012, kur lënda është transferuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, e deri tek vendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
69. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së rastit, Gjykata thekson se gjatë vlerësimit të pretendimit të palëve lidhur me te zgjatjen e procedurave, ndërlikueshmëria e një procedure duhet të shqyrtohet në kuadër të aspektit faktik dhe juridik të kontestit në fjalë (shih rastin e Gjykatës, KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 shkurtit 2018, paragrafi 56).
70. Gjykata thekson se në bazë të fakteve të elaboruara më lart, rasti i parashtrueses të kërkesës mund të konsiderohet si i ndërlikuar, në vështrim të gjendjes faktike dhe juridike.
71. Përkitazi me veprimet e palëve në procedurë, Gjykata thekson se, në dritën e praktikës gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, te zgjatja e procedurës vlerësohet edhe nga veprimet e palëve të cilat marrin pjesë në procedurë (shih, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 82; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 62).
72. Lidhur me veprimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka qenë aktive duke ndërmarrë shumë veprime procedurale, gjegjësisht duke ndjekur hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Parashtruesja e kërkesës disa herë i është drejtuar gjykatave rregullta, me kërkesë për precizim të

padisë dhe kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme me çka edhe ka kontribuar në zgjatjen e procedurës. Megjithatë nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë që parashtruesja e kërkesës të ketë parashtruar ndonjë urgjencë për përshpejtim të rastit.

73. Lidhur me veprimet e organeve kompetente në procedurën e lartpërmendur, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies së tyre në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes, ku gjatë gjithë procedurës janë nxjerrë gjithsej pesë vendime gjyqësore. Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se rasti në shkallë të parë, prej momentit kur rasti është transferuar në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, ka zgjatur 7 vite, megjithatë Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se brenda kësaj periudhe Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, kishin nxjerrë dy vendime për refuzimin e kërkesës së parashtrueses për masën e përkohshme. Në shkallë të dytë, respektivisht në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-ë, rasti ka zgjatur nga 1 dhjetori 2021 kur parashtruesja ka parashtruar ankesë, deri më 6 prill 2023 kur edhe është nxjerrë vendimi i kontestuar. Nga kjo rezultojnë se e gjithë procedura nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në vendimin e kontestuar janë gjithsej 11 vite e 6 muaj.
74. Gjykata, në dritën e rrethanave të këtij rasti, duke marrë parasysh bazën ligjore, veprimet e shumta të palëve procedurale, numrin e madh të seancave dëgjimore dhe mjetet ligjore të përdorura nga palët, si dhe faktin se gjykatat kanë nxjerrë gjithsej pesë vendime gjyqësore në këtë rast, duke përfshirë edhe vendimin e Gjykatës Komonale me të cilin ishte shpallur jokompetente, pastaj vendimet për refuzimin e masës së sigurisë dhe vendimet lidhur me meritat e rastit të Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, arrin në përfundimin se që nga momenti i vënies në lëvizje në këtë rast, nuk ishin pasive. Pra, bazuar në shkresat e lëndës dhe në dritën e rrethanave të rastit, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk kanë shkaktuar tejkzgjatje të paarsyeshme të procedurës.
75. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se lidhur me pretendimin e parashtrueses për tejkzgjatje të procedurës, parashtruesja nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj për shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, sepse faktet e paraqitura nga ajo nuk dëshmojnë që gjykatat e rregullta ia kanë mohuar asaj këtë të drejtë kushtetuese.
76. Prandaj, pretendimet e lartpërmendura të parashtrueses së kërkesës për shkelje të të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë janë pretendime “*të shkallës së katërt*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtës në pronë

77. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës para Gjykatës kishte theksuar, ndër të tjera se është shkelur edhe neni 46 i Kushtetutës, për çka nuk ka ofruar asnjë argument para Gjykatës por të njëjtat i ka ndërlidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
78. Megjithatë, Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e Pronës) i KEDNJ-së nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (shih, rastet e Gjykatës KI201/18, parashtrues *Selami Taralcu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; KI83/18, parashtrues *Ivica Milošević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së Van der Mussele kundër Belgjikës, nr. 8919/80, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48).

79. Parashtruesja e kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e saj; brenda kuptimit të kësaj dispozite "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës mund të pretendojnë "pritshtëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.
80. Por, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritshtëri legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih, rastet e GJEDNJ-së *Kopecky kundër Sllovakisë*, nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50).
81. Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se kjo e fundit nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohet konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (nenit 31 të Kushtetutës). Kjo për faktin se, sipas parashtrueses së kërkesës, gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së saj.
82. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesja e kërkesës ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.
83. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve "të shkallës së katërt", prandaj deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34, paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhalia-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani